



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.88/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 3.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës BIRN, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3.500,00 euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 22.09.2017, me të cilën pretendon se Kandidati për kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik PDK-Lirak Çelaj, në spotin e tij në rrjetin social Facebook, ka përdorur fëmijë të mitur. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë Lirak Çelaj, kandidat për Kryetar të Komunës së Prishtinës nga radhët e subjektit politik PDK, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, po ashtu Avokati i Popullit ka deklaruar se përdorimi i fëmijëve në fushata politike duhet të ndalohej.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkëngjitur një CD, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të datës 29.09.2017, theksoi se lidhur me ankesën Anr.88 me të cilën iu ka bashkëngjitur ankesës ka të bëjë me përmbledhjen e një aktiviteti të kandidatit në lagjen “Dardania” duke biseduar me qytetarët lidhur për problemet dhe shqetësimet e tyre dhe aktiviteti nuk ka qenë i mbyllur dhe nuk është thirrur asnjë qytetar për pjesëmarrje në këtë aktivitet. Subjekti politik PDK në përgjigjen e tyre lidhur me fëmijët potencuan se rastësisht janë kapur nga kamerat te një grumbull mbeturinash nuk kanë qenë të ftuar dhe as nuk kanë qenë pjesë e aktivitetit të kandidatit për kryetar z. Çelaj.

Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur disa foto të nxjerra nga video incizimi.

Subjekti politik PDK kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga BIRN të hudhet poshtë sepse skena me fëmijët është e rastit dhe jo e përgaditur.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga CD e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Lirak Çelaj, kandidat për Kryetar të Komunës së Prishtinës, nga radhët e subjektit politik PDK, ka përdorur fëmijë në spotin e tij, në rrjetin social Facebook, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre nuk e kanë pranuar shkeljen e supozuar me arsyetimin e tyre që në spotin e inçizuar nga subjekti i tyre nuk kanë qenë të përfshirë fëmijët por kanë qenë vetëm të rastit , pretendimet e tilla nga ana e panelit janë të paqëndrueshme dhe nuk kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi me këtë gjob paneli vlerësoi se me gjobën e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr. 88/2017 më datën 29.09.2017.

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shaia

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.